

## AKTI I THEMELIMIT

### TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

#### "FARRUKU" shpk

##### Neni 1

Formohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "FARRUKU" shpk me ortak te vetem Ismail Farruku, i biri i Selmanit dhe i Dhurates, dtl.1954, lindar dhe banues ne Muhur Peshkopi.

##### Neni 2

Selia e shoqerise eshte ne Muhur, Peshkopi.

##### Neni 3

Kohezgjatja e shoqerise eshte mbi 10 vjet te njepasnjeshem.

##### Neni 4

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke, qe i perket ne menyre te plote ortakut te vetem z. Ismail Farruku.

##### Neni 5

Objekti i veprimtarise ekonomike te shoqerise eshte ne fushen e shfrytezimit te pyllit, te perpunimit dhe te tregtimit te lendes drusore, me shumice e pakice, importi dhe eksporti, ne fushen e tregtimit te materialeve te ndertimit, te mallrave industriale e ushqimore, me shumice e pakice, importi dhe eksporti si dhe ne fushen e transportit te mallrave si brenda dhe jashte vendit.

##### Neni 6

Shoqeria "FARRUKU" shpk administrohet dhe drejtohet nga nje administrator i vetem qe me ane te ketij akti emerohet z. Ismail Farruku, qe eshte perfaqesuesi i shoqerise.

##### Neni 7

Fitimi i realizuar i perket tercisht ortakut te vetem e administratorit sipas dispozitave te statutit.

Viti i pare ushtrimor mbyllet me 31 dhjetor 1995.

##### Neni 8

Per çdo gje tjeter qe nuk gjen pasqyrim ne kete akt dhe as ne statut zbatohen dispozitat vendimet dhe ligjet ne fuqi.

ORTAKU I VETEM

ISMAIL FARRUKU

**S T A T U T I**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**FARRUKU SHPK**

**FORMIMI**

**Neni 1**

Formohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e emertuar "FARRUKU" shpk me ortak te votem themelues Ismail Farruku ne perputhje me aktin e themelimit.

**Neni2**

Selia e shoqerise FARRUKU shpk ndodhet ne Muhur, Peshkopi Ajo mund te hape dhe filiale te tjera brenda dhe jashte vendit.

**Neni 3**

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike te shoqerise FARRUKU shpk eshte mbi 10 vjet.

**OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

**Neni 4**

Objekti i veprimtarise ekonomike te shoqerise FARRUKU shpk eshte sa me poshte vijon :

Shfrytezim te pyllit, te lendes drusore, te perpunimit dhe te tregtimit te lende drusore, import eksport, me shumice e pakice, te tregtimit te materialeve te ndertimit dhe te mallrave te ndryshme industriale dhe ushqimore me shumice e pakice,import eksport, te transportit te tyre brenda dhe jashte vendit.

**Neni 5**

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin, seline, kohezgjatjen dhe objektin e veprimtarise se saj sipas mendimeve qe do te marre Ortaku i Vetem.

**KAPITALI I SHOQERISE**

**Neni 6**

Kapitali themelor i shoqerise tregtare eshte 100.000 leke, i investuar ne mase te plote nga Ortaku i Vetem i saj.

Kapitali themelor mund te shtohet me vendim te ortakut te vetem.

## DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

## Neni 7

Shoqeria FARRUKU shpk eshte prone e ortakut te vetem te saj, i cili gezont te gjitha atributet e asamblese se shoqerise. Administrator i shoqerise do te jete Ismail Farruku.

## Neni 8

Shoqeria FARRUKU shpk deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe permban ky statut dhe §Akti i Themelimit te saj si dhe ato te legjislacionit shqiptari ne fuqi. Shoqeria fiton zotesine per te vepruar me njohejn e saj si person juridik nga Gjykata e Rrethit te Tiranës dhe me regjistrimin si subjekt privatn ne ortanin perkates tatimor.

## Neni 9

ISmail Farruku eshte administrator i shoqerise.

## Neni 10

Shoqeria merr persiper te drejta e detyrime kontraktuese e jashtekontraktuese brenda kufijve te kapitalit te saj themelor. Ortaku i vetem bart rrezikun per veprimtarine ekonomike te shoqerise brenda kapitalit te shoqerise dhe nuk pergjigjet per detyrimet qe shoqeria ka ndaj te tËreteve me pasurine e tij vetjake.

## Neni 11

Sipas nevojave qe paraqiten per zhvillimin e aktivitetit te shoqerise administratori emerohet e puneson administratorë te tjere te cilet qendrojne ne detyre derisa revokohen nga shoqeria ose largohen me deshiren e tyre. Administratori i emeruar i ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne emer te shoqerise me perjashtim te rasteve te veçanta qe ligji i jep shrehimisht Ortakut te vetem.

## MARREDHENIET E PUNES

## Neni 12

Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per çeshtje qe kjo kontrate nuk i parashikon zbatohen dispozitat perkatese te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

**SEKRETI I PUNES****Neni 13**

Te gjithë te punesuarit ne shoqeri jane te detyruar te ruajne sekretin e punes se shoqerise. Kjo detyre vazhdon edhe pas largimit te tyre nga kjo shoqeri.

**PERFAQESIMI I SHOQERISE****Neni 14**

Perfaqesimi i shoqerise FARRUKU eshte dhe i perket ortakut te vetem te saj si dhe administratorit Ismail Farruku.

**KONTROLLI I BRENDSHEM****Neni 15**

Shoqeria "FARRUKU" shpk organizon kontrollin e brendshem me nje ekspert kontabel te autorizuar, i cili eshte pergjegjes parpara kesaj shoqerie per demet qe mund te shkaktoje nga moskryerja ne rregull e detyres se tij.

**BILANCI DHE TE ARDHURAT****Neni 16**

Veprimet ekonomike e financiare te shoqerise mbyllen me 31 dhjetor te çdo viti pervec rasteve e urdhrave te veçanta te Ortakut te vetem te saj. Ne fund te çdo periudhe ushtrimore nxirret bilanci kontabel me rezultatin ekonomik HUMBJE FITIME. Bilanci kontabel miratohet brenda dates 31 mars te vitit pasardhes dhe pas pagimit te detyrimeve fiskale pjese qe mbetet i jepet per perdorim Ortakut te vetem te saj.

**Neni 17**

Pasuria e shoqerise eshte lirisht e transferueshme dhe e trashgueshme ne rruge trashegimie.

**SHPERBERJA E SHOQERISE****Neni 18**

Shperberja e shoqerise mund te vije ne çdo kohe dhe per çfaredo lloj shkak. Ne rast mbylljeje Ortaku i vetem vendos mbi menytrat e likuidimit dhe cakton nje ose me shume likuidatore duke iu percaktuar edhe detyrat.

4.

Ne rastin e likuidimit emertimi i shoqerise do te shoqerohet nga shenimi : SHOQERI NE LIKUIDIM E SIPER. Mbase behet njoftimi i mbylljes se likuidimit dhe kryhen formalitetet e duhura, shoqeria qregjistrohesh nga regjistri tregtar i asaj gjykate.

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 19

Per sa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut i referohet plotesimeve te bera nga administratori i saj. Statuti perpaloheh ne 4 kopje per t'iu shperhdare Organeve kompetente per regjistrimin e saj si person juridik dhe si subjekt privat.

ORTAKU I VETEM

ISMAIL FARRUKU

REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA TIRANE

Nr. 2922 Rep.

Nr. 1015 Kol.

V E R T E T I M

Sot, me date 12.7.1995 u paraqit para meje noteres Ismail Farruku, per identetitein e te cilit u sigurova nga letetnjoftimi perkates, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar , i cili deklaroi para meje se akti i themelimit dhe statuti i mesiperm eshte bere me vullnetin e tij te lire dhe te plote dhe nenshkroi para meje noteres;

